



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Nr. Prot. 03-03/1450/18
Data 17-05-2018
Nr. i faq. 03
Broj stranica
Nr. pages

DATË/A:	17.05.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1427/18
PËR/ZA/TO:	z. Hakif VELIU Menaxher i zyrës së Prokurimi- Gjykata Kushtetuse e Republikës së Kosovës
CC:	z. Milot Vokshi Sekretar i Përgjithshëm-Gjykata Kushtetuse e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: Ri-tender 2 “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Passat 2.0. TDI HIGHLINE (4 MOTION)” me nr. të prokurimit 243238/18/3277/221, nr. të brendshëm 243238/18/008/221.

I nderuar z. Veliu,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: Ri-tender 2 “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Passat 2.0. TDI HIGHLINE (4 MOTION)” me nr. të prokurimit 243238/18/3277/221, nr. të brendshëm 243238/18/008/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: Ri-tender 2 “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Passat 2.0. TDI HIGHLINE (4 MOTION)” me nr. të prokurimit 243238/18/3277/221, nr. të brendshëm 243238/18/008/221, në mënyrë që të

respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 15 maj 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03/1427/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-tender 2 “**Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Passat 2.0. TDI HIGHLINE (4 MOTION)**” me nr. të prokurimit 243238/18/3277/221, nr. të brendshëm 243238/18/008/221, nr. të brendshëm 611/18/018/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Gjykata Kushtetuse e Republikës së Kosovës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma E-Prokurimi, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë e hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar 10,500.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht në kërkesën nr. 2 është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 1 (një) kontratë të natyrës së ngjashme në periudhën e shkuar 3 (tri) vjeçare*”, ndërsa tek dëshmia e kërkuara dokumentare është kërkuar: “*Një listë në origjinal të shërbimeve të realizuara në periudhën e fundit 3 (tri) vjeçare duke saktësuar: llojin e furnizimeve të përfshira, shumë e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës dhe Autoritetin Kontraktues si dhe minimum 1 (një) kopje të referencës ose raport të pranimit teknik*”, kërkesë kjo për të cilën Agjencia gjithashtu konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket *referenca apo certifikata të autoriteteve publike dhe personave privat*, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues duke cekur vetëm referenca të autoritetit kontraktues.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar të gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !